

MANOLA KAÇI (MYRTA)

VËSHTRIM MBI ELBASANISHTEN E SHKRUAR
TË VITEVE 1920-1938

Hyrje

Elbanishtja përbën një të folme e cila shpesh gjendet e përfshirë në diskutime të cilat lidhen me historinë e krijimit të variantit gjuhësor të shqipes standarde. Sikurse dihet, sidomos gjatë harkut kohor të viteve 1909- 1923 është diskutuar dhe janë marrë vendime që elbasanshtja letrare të gëzonte statusin e gjuhës së përbashkët standarde për shqiptarët.

Në të vërtetë, ekzistojnë disa institucione të cilët e përkrahën dhe i dhanë elbanishtes letrare këtë status: Kongresi i Elbasanit (1909), Komisia Letrare e Shkodrës (1916) dhe vendimi qeveritar i 1923-shit. Institucioni në të cilin u shfaq për herë të parë ideja për të vendosur variantin gjuhësor të elbanishtes letrare si gjuhë e përbashkët është pikërisht Kongresi i Elbasanit (1909), në të cilin, lidhur me këtë çështje, u arrit një vendim shumë i rëndësishëm, jo vetëm për gjuhën shqipe në tërësi, por dhe për elbanishten letrare në veçanti. Ky vendim i referohej pikës së 11-të dhe lidhej me njësimin e gjuhës shqipe duke përdorur një gjuhë letrare, pa trajta dialektore të theksuara, e cila të kishte në themel “ligjërojen” e Elbasanit, si e folme më e kuptueshme nga të gjithë shqiptarët si dhe u kërkohej të gjithë shkrimtarëve që të përdornin në shkrimet e tyre, pikërisht, të folmen e këtij qyteti.¹

Nëse i referohemi historisë së krijimit të gjuhës standarde shqipe në tërësinë e saj dhe variantit të elbanishtes në veçanti, merita për vendosjen e saj si variant gjuhësor i përbashkët për të gjithë shqiptarët i takon, natyrisht, Komisionit Letrar të Shkodrës (1916) dhe vendimeve të saj. Në Komisi u përkrah mendimi i Gurakuqit sipas të cilit: “Tue qenë, se djalekti i Elbasanit edhe ndën pikëpamjen e formavet, por sidomos ndën pikëpamjen e sintaksës është si një urë në mes të toskërishtes e të gegërishtes, duhet të zgjidhet si gjuhë shkrimi me ato rregulla orthografike, qi të na duken të drejta e t’arsyeshme”.²

Sidoqoftë, çështja e formësimit të një varianti gjuhësor të përbashkët dhe teza për elbanishten zyrtare konsolidohet e zyrtarizohet edhe më shumë kur, më 13 janar të vitit 1923, vetë shteti miraton dekretin që: si gjuhë zyrtare shtetërore të përdorej bashkëvarianti i gegërishtes jugore ose elbanishtja. Kryeministri i atëhershëm i Shqipërisë kishte autorizuar administratën shtetërore që “për bazë të

¹ Shih për më tepër: M. Myrta, *Në gjurmë të elbanishtes letrare*, temë disertacioni, Tiranë, 2014, f. 40.

² Shih për më tepër: M. Myrta, *Në gjurmë të elbanishtes letrare*, temë disertacioni, Tiranë, 2014, f. 54.

*gjuhës së shkruar zyrtare të kishte të folmen e Elbasanit*³ dhe, për më tepër, jepej urdhri që në "... gjith zyrat në shkrim të akteve zyrtare gjithmon të përdoret *djalekti i Elbasanit*".⁴

Sikurse parashtruam edhe më lart, teza për elbasanishten zyrtare ishte tashmë një realitet në kuptimin e plotë të fjalës. Pra, vullnetit të institucioneve më me peshë në Shqipëri u shtohet edhe dekreti qeveritar. Nëse në vendimin e qeverisë së 1923-shit, nuk u përpiluan kritere bazë për drejtshkrimin e këtij varianti gjuhësor, më herët, në Komisi u përpiluan dhe u përcaktuan disa rregulla bazë të cilat duhej të zbatoheshin gjatë të shkruarit. Këto rregulla ishin:

- të ruhej në shkrim ë-ja e patheksuar në trup të fjalës
- të mos pasqyrohej grafikisht kuantiteti
- të shkruheshin të plota diftongjet
- të kufizohej përdorimi i shenjës së hundorësisë
- të shkruheshin e të shqiptoheshin të paasimiluara togjet e bashkëtingëlloreve mb, nd, ngj.

Në këtë pikë, pyetja e cila, natyrisht, të tërheq vëmendjen është: Si u pritën vendimet e marra mbi elbasanishten nga autorët elbasanas? A qenë ata të hapur ndaj këtyre vendimeve e sidomos rregullave që u paraqitën nga Komisia? A i zbatuan ata në shkrimet e tyre këto rregulla?⁵

Për të krijuar një ide më të qartë rreth faktit se si u pritën vendimet e Komisionit Letrar të Shkodrës si dhe vendimi i qeverisë së 1923-it për vendosjen e elbasanishtes si modeli i gjuhës së përbashkët standarde shqipe, sidomos në qarqet e shkruarve dhe figurave më të njohura të qytetit të Elbasanit, kemi përqendruar vëmendjen në shqyrtimin e disa prej autorëve e periodikëve të kohës. Më konkretisht, jemi përqendruar në vëzhgimin e dukurive gjuhësore në "Fletorja zyrtare" e viteve 1922-1923, në shkrimet e autorit Filip Papajani (me pseudonimin Lipi), në gazetën "Shkumini" (1921) si dhe të Kostandin Cipos (Nisus) në gazetën "Ura e Shkumbinit"⁶ (1924). Pjesë e studimit kanë qenë edhe tragjeditë e autorit elbasanas Ethem Haxhiademi: "Aleksandri"⁷ dhe "Abeli"⁸.

Përzgjedhjet e veprave të mësipërme janë bërë mbështetur në faktin e të pasurit të një përkimi të mundshëm kohor qoftë me vendimin e marrë në Kongresin e Elbasanit e në Komisionin Letrar të Shkodrës, qoftë me vendimin e qeverisë, qoftë me periudhën e mëvonshme.

³R. Ismajli, *Gjuhë standarde dhe histori identitetesh*, Tiranë, 2005, f. 56.

⁴M. Çeliku, *Çështje të shqipes standarde*, Tiranë, 2009, f. 124.

⁵Shih për më tepër: M. Myrta, *Në gjurmë të elbasanishtes letrare*, temë disertacioni, Tiranë, 2014, f. 56-58

⁶Siç edhe vihet re, ndonëse me tituj të ngjashëm, në botimin e 1924 në fjalën *Shkumbini* shkruhet i plotë grupi mb.

Kjo mund të lidhet edhe me vendimin e qeverisë së 1923-shit.

⁷E. Haxhiademi, *Aleksandri*, Tiranë, Kristo Luarasi, 1931.

⁸E. Haxhiademi, *Abeli*, Elbasan, 1938, ribotim, shtëpia botuese "Onufri", Elbasan, 1993.

Gjatë studimit, jemi përqendruar në vëzhgimin disa karakteristikave të përgjithshme gjuhësore, kryesisht, të aspektit fonetik e gramatikor, për të nxjerrë në pah faktin në janë përpjekur këta autorë të ndjekin rregullat e përcaktuara nga Komisia Letrare.

Gjatë shqyrtimeve të dokumenteve të mësipërme kemi vënë re këto dukuri gjuhësore:

A. Dukuri gjuhësore të aspektit fonetik:

1. Përdorimi i zanores hundore a: Kjo zanore është e pranishme tek të gjithë autorët. Ethem Haxhiademi në tragjedinë “Aleksandri” përdor: *nanë, dhandër, gja, hanë, andërr, dit’t’ambël, atit tand, bani, asht*. Ndërsa tek “Abeli” shfaqen përdorimet: *gja, nanë, çashtje, dit t’ambël, e ambël, hange, hangrëm, asht, damtojë, duhet thanë; andrra, za, dam, anda, landë, e randë, të zanë, bajnë* (Papajani⁹); *andrra, andërr, stinat, kangë, asht, bani, ma* (Cipo); *çashje, asht, i ashtë, ban, të randë, gjasend* (Fletorja zyrtare).

2. Grupi va: Tek Tragjedia “Aleksandri” shfaqet i lëkundur përdorimi i këtij grupi, ndaj edhe e hasim të formë të dyzorësuar, si në rastin: *t’vjen në votër, por m’erdhi në vatër*. Papajani përdor grupin vo: *vorret e juej*. Grupin vo e takojmë edhe në “Fletorja zyrtare”: *voj gurit*.

3. Drejtshkrimi i dyzanoreve ue, ye dhe ia, ie: Haxhiademi shfaq prirjen për t’i shkruar të plota dyzanoret, si në fjalët: *e krijuesit, ka shie, të duesh, po vuen, për t’i vuejt*, etj. Interesant është fakti që në veprën Abeli” vihet re përdorimi i zanores ë në vend të zanores e në këto grupe: *muë, duëm, asht krijuë, nuk duë, mos thuëj, ruën, s’i mjaftuëka por edhe luan, arsyë*. Krahës këtyre formave të paasimiluara autori përdor edhe trajtat e asimiluara: *dumë, duje, thuju*. Papajani i ruan mirë grupet e zanoreve: *ta’mshueshëm, e juej, e jueja, qe shue, për të largue, qe shue, tyke e quejt, murën, duel, nuk duen, plotsue; nje, shërbyen, u dëftye; vrapuan*. Edhe Cipo, përgjithësisht, i ruan të plotë këto grupe: *vuejtimet, e kalueme, vuej, i due, për mue, qi vunte, mbuell, shërue*. Në “Fletorja zyrtare” i takojmë, pothuaj, po ashtu të plotë grupet e zanoreve: *kritikuesit, e caktueme, kohës së kalueme, e qytetnueme, të shkretueme, të rrënueme, kan me u dërgue, me veprue, u emnue, me këndue, me shkruue, qi fitueme, pa u kujtue, munguen; Kryeministriës, e thyeme, u kryen, në krye, ka pëlqye, të thyejnë, me shkuem; e quajtun*.

4. Përdorimi i grupeve të bashkëtingëlloreve mb, nd, ng dhe ngj. Përsa i përket grupeve të bashkëtingëlloreve tek Haxhiademi bie në sy prirja e drejtshkrimit të plotë të tyre në pjesën më të madhe të rasteve: *vend, nder, nderin, mendje, Perëndis, n’diell, n’gjendje, ti ndifi, t’shnerohet s’mundem, m’i kundërshtuë, t’prindvet, e randë, të ndreqi, këndojnë, ndëgjo, mendo, këndojnë, të mundohesh, ndihmon, kuvendon, ndoshta; shkamb, mbretnesh, mbretëninë, mbretnis, zymbyla, mbi dhe, mbi të rinë, t’ambël, i ambël, dit t’ambël, mbret, të mbarë, djal i mbarë, përmbledh, përmbahu, mban, mbasandaj; ka ngranë, hange,*

⁹ Shembujt janë marrë nga “Fletorja zyrtare”, Tiranë, vjeti 1922 dhe “Fletorja zyrtare”, Tiranë, vjeti 1923.

hangrëm, nga jeta, nga i vllai; krah at e ngjoma, më ngjanë, çdo mëngjes. Të paasimiluara shfaqen edhe te Papajani: kombëtar, t'ambël, të mbretënonte; pendën, e kandshme, as nderë, ndihmë, mendimet, katund, andrrat, mundimi, landë, mund të shpërblehen, neroj, t'i ndihni, mundohen, ndonjë, kundër; ngrehën, nuk ngrifet, nga karta. Të tilla i takojmë edhe te Cipo: tembull, mbuell mbas; sëmundje, mendohem, nuk mundem, më mundojnë, të ndërrojnë, këndohet, qi këndoi, gjindesh, endi; kangë, kangën. Në "Fletorja zyrtare" grupet e bashkëtingëlloreve ruhen, po ashtu, të plota: vendim, vendin, kundërshtim, katund, katundi, vendi, e fundit, ndër mend, asht vendos, qi ndodhet, qi nda, ndalojnë, s'mund, mundemi, qi gjinden, smundje, ndalohen, andej; në mbarim, kombtare, kombëtar, mbaron, përmbajnë, mas, si mbas, pesmbëdhit, për mbrenda, përmbaruëse, mbrenda; t'i ngarkohen, ngatrrsat, u nrit, tue ngritë.

5. Prania e zanores ë të pazëshme në pozicion fundor e jofundor: Lidhur me zanoren ë fundore dhe jofundore duhet thënë që ajo ruhet mirë tek këta autorë në sisteme të ndryshme: qoftë në sistemin emëror, mbiemëror, foljor e ndajfoljor. Haxhiademi shfaq këto përdorime: *vashë, me vlerë, fam, kunor, anë, nanë, derë, në vajë, shpatë, fjalë, gjam, frikë, shpresë, zilinë, punë, kafshatë, dhuratë, gojë, vajzë, të mjerë, të drejtë, të denjë, të ligë, të kotë, të qet, i vëtrertë, të ligë, e zezë, sy të mirë, i shkretë, lashë, paska sjellë, mirë, këndeje, përgjithmonë.* Papajani, gjithashtu, e ruan këtë zanore si në pozicionin fundor ashtu edhe në pozicion jofundor: *dritë, shqiptarë, punë, as nderë, detyrë të shejtë, e randë, të gjallë, një, që, më (ma), oshëtijnë, do të jetojnë, të krijojmë, të zanë, të veprojnë, do të punojnë, shumë;* (zanorja ë jofundore): *qetësin, oshëtijnë, shoqënit, gëzimi, që kënaqen, të gjallë, e paskëtajme, të mbretënonte.* Të pranishme, këtë zanore, e gjejmë tek Cipo: *copë, herë, natë, dritë, ditë, më mundojnë, më copëtojnë, të ndërrojnë;* (zanorja ë jofundore): *të largëta, këndohet, sëmundje.* Në "Fletorja zyrtare" shfaqet e dukshme prirja e ruajtjes së zanores ë: *nga drutë, dorë, fjalë, kambë, madhësin, frymë, mënyrë, të randë, përmbajnë, jetojnë, po na shkrinë, vijojnë, me pritë, me marrë, bajmë, t'a bajnë, të hyjmë, mund të bëjmë, bashkë;* (zanorja ë jofundore): *tregëtar, kopësht, burrënin, kombëtar, t'ardhëshme, (frymë) përgjegjëse, qi përfaqësojnë, urdhënojmë, gëzojmë, kështu, lehtësisht, atëherë.*

6. Kalime tinguish.

Lidhur me këtë aspekt janë vënë re këto dukuri në veprat e autorëve të shqyrtuar:

a. Kalimi i zanores ë në zanoren i: Këtë dukuri e kemi hasur të pranishme në përdorime të tilla: *t'më shohi, t'më dalish, ndezish, të hypish, ndonji, përnjiher, gjithnji* (Haxhiademi); *nji, ta veshi, nonji, qi provoj, gjindesh, i dishruem* (Cipo); *dishiron, ndo nji, mbi taksin* (taksën) (Fletorja zyrtare).

b. Kalimi i bashkëtingëllores h në bashkëtingëlloren f: Ky kalim është i pranishëm, ndonëse me një përdorim të rrallë: *të më rrafi, shofin, nuk ngrifet* (Papajani); *të më rrafi* (Cipo).

c. Zëvendësimi i zanores u me zanoren y. Ky kalim takohet, sidomos, tek përemri ai dhe formanti duke i formës së pashtjelluar përcjellore. Të tillë e përdor Haxhiademi: *ay (ai), tyke u ba, tyke mos ba, tyke gëzuë, tyke punuë, tyke ruëjt,*

tyke liruë, tyke mbëledhun. Tek këtë formë e përdor edhe Papajani: *tyke ba, tyke rrezikue, tyke dhanë, tyke e quejt, tyke mos pasë, tyke i pa.* Këtë formant e takojmë edhe në “Fletorja zyrtare”: *tyke marrë, duke i dhënë, tue fluturuem, tue ngritë, tue qenë.*

7. Prania e ndërzanores -n-: Këtë kalim e kemi takuar gjerësisht, si tek “Fletorja zyrtare”, ashtu edhe ndër autorët elbasanas. Haxhiademi përdor: *dashnin, dashuni, pasuni, kunor, nanë, anmiqsija, anmiku, madhni, prindën, të mbretnis, idhnimin, n’prehën, prej gjinit ‘ tyne, emën, urdhnin, mënin, anmiq, vllazën, i pleqënis, laknat, lumtunin, dashunija, dashnija; e dashun, Maqenonis së gjanë, midis tyne; urdhnon, do t’urdhënojë, më vune.* Papajani: *emën, emnin, n’errësinën, të ditunis, dituni, shoqënit, zotni, pasjen e tyne, jetën e tyne, idealizmin e tyne, vllaznit e tyne, në atdhedashunin e tyne, urdhënoni, të mbretënonte; Cipo: dimnit, bani, e tyne; në “Fletorja zyrtare”: të paditunit, i padituni, n’emën, të vdekunvet, nga i vdekuni, nga pasunija, pasunin, këtyne, letër zotnimi, letër zotnimet, kufini, mjerimet e varfënis, shoqënvit, emnime, Toskënis.*

B. Dukuri gjuhësore të aspektit morfologjik

1. Lidhur me kategorinë gramatikore **të emrit** janë vënë re këto dukuri:

- Shumësi i emrave: Tek Haxhiademi dhe autorët e tjerë, sikurse te Kristoforidhi, kemi takuar shumësin me **a:** *kokrra, kraha (t’njoma), krahut (e mija); libra të bukra, në kraha, lotë të zjarra, hapin krahut, landë të vjetra (Papajani); stinat, rudinat e buta, telat (Cipo); degat, syzat (Fletorja zyrtare).*

- Përdorimi i rasës kallëzore me mbare të **-n:** *lumnin (lumturinë), gjumin, dashunin, ngushëllimin, njerzin (Haxhiademi); qetësin, pasjen, jetën, gjumin, idealizmin, gjuhën, djersën, torbën, në atdhedashunin, zemrën (Papajani); pushimin, zemrën (Cipo); me kërkimin, pasunin, pasunien, burrin, livadhin, bashkpunimin, botën, Shqipnin (Fletorja zyrtare).*

- Përdorimi i i rasës vendore: *n’punët të mbretnis, n’mushkënit, në prehën t’prindvet, prej sjelljeve, drejt prindvet, kundrejt prindvet (Haxhiademi);¹⁰ në buzët, shoqevet, mbi kokët, rebelavet, mbretënvit, Ministris së Metalevet (Papajani); mbas dimnit t’egër (Cipo); të vdekunvet, prefekturavet, mbas pasqyravet, të prishunat, shoqënvit, gjanavet, në dasmët (Fletorja zyrtare).*

Përsa i përket kategorisë gramatikore **të mbiemrit** vihet re: prania e mbiemrave prejpjesorë me prapashtesën **-m(ë)**, dhe **un(ë)**: *i gabuëm, të bashkuëm, i tërbuëm, e pajueme, e mësueme, e pamartueme, e gëzueme; djal i dashun, i dashtun burr, at i dashtun, nanë e dashtun, i lumtun (Haxhiademi); ideali ta’mshueshëm, të përvaishëm, të shkëlqyeshëm, i pa tundshëm, t’ambël, e kandshme, të nevojshme, e poshtme, e paskëtajme, e pavarme, të flakët, të shejtë, të domosdoshme, lotë të zjarra, të panjohtun, të rritun, të plakun, të djegun, frone të nalta, të flakët (Papajani); të hyishme, e kalueme, të mërziqme, e thyeme, të merme, i dishruem, të pa njoftun, të bukura (Cipo); e preme, të detyrueme, e pashenjume, të pruem, të ndershme, e qytetnueme, kohës së kalueme, të*

¹⁰ Duhet pohuar që tek vepra “Abeli” kemi një reduktim të dukshëm të kësaj rase.

shkretuem, të rrënuem, të maruna, e ngrehun, e mbetun, i shtypun, i ndrydhun, të ndodhuna, të përmenduna, i mbytun, caktueme, e kufizume, të këtushme, të naltpërmendun, t'anshëm, të ndjekun (Fletorja zyrtare).

2. Sistemi foljor.

Lidhur me sistemin foljor janë spikatur këto dukuri:

a. Përdorimi me kuptimin e së ardhmes edhe i formave perifrastike **kam+paskajore** krahas të ardhmes me do + lidhore: *ka me i paguë, ka për me pjellë, nuk ka m'u bamun, kan me m'thrrit, keni me shikuëm, do t'mbarohet, kemi m'u dashun, ka me u gëzuë, s'kam me ta harruë, kam me t'i shpërblye, s'kam me ta harrumun (Haxhiademi); kan me i shulite, s'kanë me dredhë, kam me të shërue, kanë me çelë, kan me i shulite, s'kanë me dredhë, s'kanë me ditë, kam me të shërue, kanë me çelë (Cipo); ka me u shikue, kishim me pasë, ka me mbet, qi ka me u dhanë, kan me u dërgue, do të epen, do të mbajnë (Fletorja zyrtare)*

b. Pjesoret e foljeve formohen me anë të prapashtesës **un**: *mbyllun, ardhun, lshumun, lëshumun, dashun, harrumun, mbëledhun, mundun, bamun, çumun, mbajtun, shpëtumun, bredhun, ardhun (Haxhiademi); ngrehun, përmendun, mërzitun, ndodhun (Fletorja zyrtare); tek Papajani takojmë pjesoret e tipit: zanë, shue, kishte mbetë, të kishte vdekë, ka marr, kam derdhë.*

3. Prania e paskajores: *për me sunduë, me kundërshtuë, me kqyr, me shkuë, me zemrue, mos me pa, me ngran, mos me e prekë, me na ndaluë, për t'siguruë, asht për t'u pëlqyë, për t'i kqyrë, por edhe format: për t'u bamun, për të kapun, për me e mbajtun, për me shpëtumun, për t'bredhun (Haxhiademi); kan me i shulitë, s'kanë me dredhë, me ditë, kam me të shërue, kanë me çelë kan me i shulite, s'kanë me dredhë, me ditë, kam me të shërue, kanë me çelë (Cipo); për të largue, për t'i përqafue, për të punue, me i plotsue, s'kam mundë (Papajani); ka me u shikue, kishim me pasë, ka me mbet, qi ka me u dhanë, kan me u dërgue (Fletorja zyrtare).*

4. Përdorimi i përcjellores në format **tuke/tyke + pjesore**: *tuke më cytë, tuk'derth, tyke u ba, tyke gëzuë, tyke mos ba, tuke më cytë, tyke u ba, tyke gëzuë, tyke mos ba (Haxhiademi); tyke ba, tyke rrezikue, tyke dhanë, tyke e quejt, tyke mos pasë, tyke i pa (Papajani); tyke marrë, duke i dhënë, tue fluturuem, tue ngritë, tue qenë (Fletorja zyrtare).*

5. Përdorimi i formës së plotë të një grupi ndajfoljesh si: *kështu, ashtu mirë, mbassi, ndonj'herë përgjthmonë, kënde, përpara, poshtë, mbasandaj, mbaskënde, për disa prej të cilave vepron dukuria e asimilimit ose e rënies së zanores ë në elbasanisht.*

Nëse do të bënim një krahasim të tipareve gjuhësore të mësipërme me tiparet gjuhësore të elbasanishtes së sotme, nën vështrimin e rregullave të përcaktuara në Komisi çfarë do të na rezultonte? Mendimi më i shpejtë dhe i natyrshëm do të ishte rreth zbatimit të rregullave të vendosura në Komisi, si një dëshirë e ndërgjegjshme e autorëve elbasanas për të krijuar një variant gjuhësor të përbashkët për shqiptarët mbi bazën e elbasanishtes.

Në të vërtetë, nisur nga paraqitja e dukurive gjuhësore të mësipërme na rezulton një përkim i dukshëm i rregullave drejtshkrimore të vendosura nga

Vështrim mbi elbasanishten e shkruar të viteve 1920-1938

Komisja dhe tipareve të përgjithshme gjuhësore që takojmë në shkrimet e autorëve elbasanas. Ajo që mund të pohojmë është që në shkrimet e tyre, përveç tipareve gjuhësore të elbasanishtes në disa raste ata edhe e “cënuan” me vetëdije atë, për të zbatuar vendimet e Komissisë.

Këto “thyerje” apo “cënime” të ndërgjegjshme të sistemit gjuhësor të elbasanishtes nga këta autorë, nëse mund t’i quajmë kështu, lidhen me:

- Drejtshkrimin e zanores ë fundore dukuri e cila nuk është e pranishme në elbasanisht, sikurse edhe në të folme të tjera të gegërishtes së Shqipërisë së mesme.

- Drejtshkrimin e zanores ë të patheksuar në trup të fjalës, e cila pothuaj nuk dëgjohet në këtë të folme.

- Praninë e plotë të grupeve të bashkëtingëlloreve *mb, nd, ng, ngj* të cilët përgjithësisht përdoren të asimiluar.

- Drejtshkrimin e plotë të diftongjeve *ue, ye* dhe *ia, ie* të cilët në pjesën më të madhe reduktohen, përkatësisht, në zanoret *u, y* dhe *i*.

Ky është realiteti që takuam në këtë numër disi të kufizuar autorësh e shkrimesh, por a mundemi ne, në të vërtetë, ta quajmë pa kurrfarë hezitimi këtë realitet gjuhësor si një “thyerje” apo “cënim” të ndërgjegjshëm të sistemit gjuhësor të elbasanishtes?

Nëse shkojmë disi më parë në kohë do të ndeshemi me faktin gjuhësor që e folmja e Elbasanit, në fazat më të vjetra, ishte shumë më pranë toskërishtes nga ç’është sot”.¹¹ Këtë gjë e tregojnë fakte e hulumtime të dokumentuara. Një fakt të tillë e pohon Dh. Shuteriqi gjatë studimit të dorëshkrimeve të Anonimit të Elbasanit (sipas Shuteriqit: Teodor Borgomili). Në një dorëshkrim të tij, ndoshta të vitit 1761, gjuha e përdorur “paraqet tipare më arkaike se ajo e Todrit, që nga një anë përkon me veçoritë gjuhësore të teksteve të vjetra të Veriut, dhe nga ana tjetër me tiparet e toskërishtes së vjetër.”¹² Afria me gjuhën e autorëve të vjetër, e cila përkon me atë fazë të shqipes kur dy dialektet gjendeshin më pranë njëri-tjetrit, e kanë bërë Shuteriqin të shprehë mendimin që dorëshkrimi i tij mund të quhet i bashkëkohshëm me tekstet e vjetra të shek. XVII. Ndërkohë, afërsitë e dukshme me toskërishten mund të lidhen me krahinat jugore të Elbasanit, ku puqen tiparet e të dy dialekteve. Por, nga ana tjetër Shuteriqi hedh gjithashtu hipotezën e një përpjekjeje të parë e të ndërgjegjshme për të shkruar një gjuhë të përzier, d.m.th. të përbashkët shqipe qysh së lashti.¹³

Këtë mendim e përkrah edhe Elsie kur shprehet se autori ndoshta përpiquej të shkruante në një gjuhë të përbashkët që ta kuptonin të gjithë shqiptarët nga krahina të ndryshme.

Një dukuri të tillë e ka vërejtur edhe Hahni i cili, mbështetur në studimin e tipareve gjuhësore të fragmenteve të gjetura në Manastirin e Shingjonit dhe të botuara nga Hahni, Geitleri, Pekmezi, Nachtigalli, Lef Nos e Shuteriqi, pohon që

¹¹ Po aty, f. 254-255.

¹² Po aty, f. 252.

¹³ Po aty, f. 254.

gjuha e përdorur prej tij shfaq tipare të dukshme me toskërishten.¹⁴ Po kështu, Hahni ka vërejtur që dialekti i përkthimit të përdorur në një fragment të ungjillit “duket shumë i purifikuar dhe shumë i afruar me toskërishten, ndryshe nga poezitë geqe që gjendeshin në një fletore tjetër.”¹⁵

Për më tepër, mjaft interesant është edhe fakti që gjatë studimit të teksteve të shkruara nga Dhaskal Todhri, Hahni pranon mendimin që Todri u mor me krijimin e një gjuhe letrare të përbashkët për të dy dialektet e shqipes aq të ndryshëm nga njëri-tjetri.¹⁶

Në këtë pikë, mbështetur në parashtrimet e mësipërme, ç’mund të thuhet për autorët elbasanas? Këto fakte gjuhësore na bëjnë të mendojmë që elbasanishtja e shkruar e këtyre viteve të përkundet midis dy hipotezave të shumëfolura nga studiues shqiptarë e të huaj: nga njëra anë qëndron ideja e elbasanishtes së vjetër me tipare gjuhësore më pranë toskërishtes dhe, në anën tjetër, ideja e një përpjekjeje të ndërgjegjshme nga autorët elbasanas për formësimin e një varianti gjuhësor me elementë të përbashkët prej të dy dialekteve.

Lidhur me këtë problematikë, A. Omari është e mendimit që “pavarësisht nëse kjo përzierje gjuhësore është bërë me vetëdije ose jo, atë e ka lehtësuar fakti që e folmja e Elbasanit, në fazat më të vjetra, ishte shumë më pranë toskërishtes nga ç’është sot”.¹⁷ “Shkrimi në një gjuhë “të përzier”, me tipare të të dy dialekteve, nuk mund të pohohet me siguri nëse është bërë në mënyrë të vetëdijshme apo është rezultat i bazës dialektore të autorëve elbasanas e cila i përmbante asokohe këto tipare. Mendimi ynë anon nga hipoteza e fundit”.¹⁸ Por, përtej këtij realiteti, gjatë periudhës pas Komisës dihen përpjekjet e ndërgjegjshme të autorëve elbasanas për krijimin e varianti gjuhësor me elementë të përbashkët të të dy dialekteve. Vlen të përmendet në këtë pikë qëndrimi i vetë gjuhëtarit elbasanas Aleksandër Xhuvani i cili në parathënien e tekstit të tij “Libri i Gjuhës”, vepër e botuar në Elbasan më 1919, shënon: “Në punë t’orthografisë e të shkëlqimit gramatikore e pashë me udhë, qi t’i ruej si shkëlqet rregullat orthografikë, qi themeloi Komisija letrare e Shkodrës”.¹⁹ Më poshtë autori shton: “Sa për orthografin e trajtave të tjera gjuhsore, si mënyrën e shkrimit të participevet, të mbiemravet, etj., punë që nuk e dau edhe ajo komisi, ndoqa një udhë të mesme tyke përdorun edhe trajta toskënishte, por edhe tyke mos dalë nga parimi themelor,

¹⁴ Po aty, f. 251.

¹⁵ Po aty, f. 252.

¹⁶ A. Omari, *Fillesat e idesë për një gjuhë të përbashkët letrare shqipe*, në “Një rilindje para rilindjes”, Gjirokastër, 2014, f. 250.

¹⁷ Po aty, f. 254-255.

¹⁸ Po aty, f. 257.

¹⁹ M. Çeliku, *Kongresi i Manastirit vështruar pas 100 vjetësh*, në “Çështje të shqipes standarde”, Tiranë, 2009, f. 128-129.

Vështrim mbi elbasanishten e shkruar të viteve 1920-1938

qi vuni ajo Komisi e qi asht se Orthografija e gjuhës do të ketë për bazë dialektin e Elbasanit”.²⁰

Qëndrim të ngjashëm me Xhuvanin mbajti edhe një autor tjetër elbasanas (drejtor i Shkollës Normale) i cili në parathënien e librit të tij “Këndime për Shkolla fillore”, botuar po në Elbasan më 1919, thotë: “Mëngimi i librave për këndim dhe vendimi i Komisionit Letrar i Shkodrës, qi të përdoret dialekti i Elbasanit nëpër librat e shkollës, më shtyën, qi të shkruiej këtë libër...”.²¹

Ajo çka duhet nënvizuar është fakti që në traditën shkrimore të elbasanishtes përpjekja e ndërgjegjshme për ta afruar elbasanishten me toskërishten letrare, kishte nisur që me Kristoforidhin. Një gjë të tillë e ka bërë edhe Dhimitër Shuteriqi në abetaren e tij që u botua në Manastir më 1911, pra, pesë vjet para Komisionit Letrar. Edhe titulli i saj “Abetarja shqip rrieshtuar në gjuhë të përbashkme” shpreh qëndrimin e autorit rreth përdorimit të një gjuhe të përbashkët.²²

Fakte të tilla na bëjnë të mendojmë që nëse në faza më të hershme të shkrimit të saj, elbasanishtja ishte më pranë toskërishtes, vështirë që mund të pohojmë thjesht një vijimësi të kësaj tradite për periudhën kohore gjatë së cilës në Shqipëri po bëheshin përpjekje për kristalizimin e variantit të përbashkët të gjuhës shqipe, gjuhën e përbashkët shqipe, apo variantin standard të shqipes sot. Ndaj këtë rezultat është e udhës që ta shohim e interpretojmë si një bashkëveprim të të dy elementëve: të një baze të trashëguar dialektore me tipare më pranë toskërishtes, e cila nuk mund të shfaqej në atë formë gjatë periudhës pas Komisionit pa ndërhyrjen e këmbënguljes e vetëdijshme të autorëve elbasanas.

Sidoqoftë, shembujt e mësipërm flasin qartë rreth faktit që, pavarësisht se nuk arriti të bëhej kurrë modeli shkrimor i një shqipeje standarde të përbashkët për të gjithë shqiptarët, elbasanishtja letrare pati mbështetjen e plotë të autorëve elbasanas, ajo u formësua si e tillë, është ende aty dhe e tillë do të mbetet gjithmonë, mes atyre faqeve të zverdhura prej rrjedhës së kohës.

BIBLIOGRAFI

- A. Omari, *Fillesat e idesë për një gjuhë të përbashkët letrare shqipe*, në “Një rilindje para rilindjes”, Gjirokastër, 2014.
- E. Haxhiademi, *Abeli*, Elbasan, 1938, ribotim, shtëpia botuese Onufri, Elbasan, 1993.
- E. Haxhiademi, *Aleksandri*, Tiranë, Kristo Luarasi, 1931.
- Fletorja zyrtare*, Tiranë, vjeti 1922.
- Fletorja zyrtare*, Tiranë, vjeti 1923.
- M. Çeliku, *Çështje të shqipes standarde*, Tiranë, 2009.
- M. Çeliku, *Kongresi i Manastirit vështruar pas 100 vjetësh*, në *Çështje të shqipes standarde*, Tiranë, 2009.

²⁰ M. Çeliku, *Kongresi i Manastirit vështruar pas 100 vjetësh*, në “Çështje të shqipes standarde”, Tiranë, 2009, f. 129.

²¹ M. Çeliku, *Kongresi i Manastirit vështruar pas 100 vjetësh*, në “Çështje të shqipes standarde”, Tiranë, 2009, f. 129.

²² Po aty.

MANOLA KAÇI (MYRTA)

M. Myrta, *Në gjurmë të elbasanishtes letrare*, temë disertacioni, Tiranë 2014.

R. Ismajli, *Gjuhë standarde dhe histori identitetesh*, Tiranë, 2005.